



Titulli i projektit

Evidentimi dhe Rehabilitimi i Mbetjeve Sterile dhe Karrierave si rezultat i shfrytëzimit të Mineraleve

Tipi i projektit

Mjedisor

Vendndodhja e projektit

Bicaj

Buxheti i paravlerësuar

200,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Situata e krijuar që para vitit 1990, nga shfrytëzimi i mineraleve në Gjegjan dhe shfrytëzimi i rërave karbonatike në Komunën Bicaj është e rëndë. Pas ndryshimit të sistemit, në këto dy vendburime u krijua një gjendje shumë negative me pasoja të mëdha mjedisore. Një gjendje e tillë u krijua edhe si rezultat i krijimit të damkave sterile të skorjes së Uzinës së Shkriqes së Bakrit në Rexhepaj (Komuna Shtiqën), e cila ndikon në ndotjen e ujërave të Liqenit të Fierzës. Problem shqetësues është shfrytëzimi i zonave mineral-mbajtëse pas vitit 1997 dhe në vazhdim nga persona të palicencuar. Shfrytëzimi i karrierave realizohet nga subjekte e persona privatë, në shumë raste pa kualifikimin e duhur dhe pa zbatuar projekte e programe që shoqërojnë licencat. Shpesh karrierat përfaqësojnë vetëm gropa ose gërmime me konture të parregullta, pa shkallë, pa iu përmbytur sistemit të shfrytëzimit të parashikuar në projekte dhe çka është shumë shqetësuese, pa marrë asnjë masë për rigjenerimin e mjedisit.

Qëllimi/et specifik të projektit

Promovimi i shfrytëzimit me efektivitet të karrierës karbonatike në mënyrë që të mbështetet zhvillimi i industrisë së ndërtimit të rajonit dhe të sigurohet mbrojtja e mjedisit.

1. Objektivat specifike të projektit

OS1: Të bëhet e njohur gjendja aktuale si pasojë e shfrytëzimit të mineraleve në Qarkun Kukës.

OS2: Të përpilohet një raport teknik për zgjidhjen e problemeve.

OS3: Të kthehen zonat e dëmtuara nga veprimtaria minerare në zona pa ndotje në mjedisin rrethues.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

R1: Banorët e zonave të ndërhyrjeve do të jetojnë në kushte më të mira mjedisore dhe sigurie

R2: Qeverisja Qendrore dhe ajo lokale kanë informacionin e duhur për ndërhyrje rehabilituese

R3: Bizneset në fushën minerare do të sensibilizohen për mbrojtjen e mjedisit

PROJEKTI 7



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

1. Ekspedita dhe vrojtime në terren për njohjen e sipërfaqeve të dëmtuara
 2. Analizim i fakteve të marra në terren
 3. Takim me grupet e interesit
 4. Rehabilitim i zonave më prioritare të dëmtuara
 5. Fushatë për sensibilizimin e kompanive të licencuara për mbrojtjen e mjedisit në zbatim të legjislacionit në fuqi
- Projekti mendohet të zbatohet në një periudhë 2-vjeçare.

Maturimi i projektit

N/A

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

- Projekti do të zbatohet nga:
- Agjencia e Zhvillimit Rajonal Kukës
 - Këshilli i Qarkut Kukës
 - Bashkia Kukës

Kostot e projektit

Ekspedita dhe vrojtime në terren për njohjen e sipërfaqeve të dëmtuara 30,000€
Analizim i fakteve të marra në terren 10,000€
Takim me grupet e interesit 10,000€
Rehabilitimi i zonave më prioritare të dëmtuara 140,000€
Fushatë për sensibilizimin e kompanive të licencuara për mbrojtjen e mjedisit në zbatim të legjislacionit në fuqi 10,000€